

## **Dita Evropiane e Gjuhëve : 26 shtator 2006**

Strasbourg, 24.09.2007 –“ Gjuhët dhe të mësuarit e gjuhëve janë thelbësore për promovimin e vlerave të demokracisë dhe të të drejtave të njeriut në Këshillin e Evropës”, tha Terry Davis, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

“ Aftësitë gjuhësore ndihmojnë njerëzit të kuptojnë dhe të respektojnë njëri tjetrin, të flasin dhe të dëgjojnë njëri tjetrin” shtoi ai. “ Kjo është arsyeja se pse 26 shtatori, Dita Evropiane e Gjuhëve është kaq e rëndësishme”

Dita Evropiane e Gjuhëve, e cila u deklarua nga Këshilli i Evropës gjatë Vitit Evropian të Gjuhëve më 2001, festohet në mënyrë të përvitshme me qindra veprimtari nga çdo shtet anëtar.

Qëllimi është të tërheqim vëmendjen e publikut për pasurinë gjuhësore evropiane. Gjithashtu, Dita shërben si një kujtesë për nevojën për të mësuar gjuhë të tjera në mënyrë që ne të vlerësojmë më mirë vlerat dhe përfitimet e diversitetit tonë kulturor. Informacionin për veprimtaritë e shumta të planifikuara nga vendet anëtare të Këshillit të Evropës për 26 shtatorin mund ta gjeni në faqen e internetit të Këshillit të Evropës [www.coe.int/EDL](http://www.coe.int/EDL).